



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhësi Teksti

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Semestri kur zhvillohet: Viti III / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor - Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të marrë njohuritë bazë të lëndës së gjuhësisë së tekstit në gjuhën turke.
- Të organizojë informacionin e marrë për lëndën e gjuhësisë së tekstit.
- Të analizojë një tekst në gjuhën turke bazuar në parimet e tekstualitetit.
- Të dallojë strukturat gjuhësore të gjuhës turke që mundësojnë kohezionin dhe koherencën e tekstit.
- Të kuptojë një tekst në gjuhën turke.

Objektivat specifike lëndore:

- Të analizojë një tekst duke marrë parasysh parimet e tekstualitetit.
- Të dallojë njësitë gjuhësore me të cilat jepet katafora dhe anafora në një tekst të caktuar në gjuhën turke.
- Të përdorë drejt elementët lidhëzorë të tekstit.
- Të analizojë strukturën sipërfaqësore dhe strukturën e thellë në një tekst të caktuar në gjuhën turke.
- Të dallojë lidhjet formale dhe lidhjet kuptimore në një tekst të caktuar në gjuhën turke.
- Të kuptojë dhe të analizojë drejt kohën e veprimit dhe rrëfimit në një tekst të caktuar.